



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
**SPITALI RAJONAL SHKODER**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**DETYRE PROJEKTIMI**

**EMËRTIMI I INVESTIMIT:**

Hartimi i Projekt Preventivit me objekt: “Rikonstrukcion godinë të Maternitetit  
(Obstetrike,Gjinekologji,Neonatologji,ORL-OKL dhe Dermatologji)



## **POROSITËS:**

Spitali Rajonal Shkodër

## **VËNDI I NDERTIMIT**

Godina ekzistuese e Maternitetit e cila ndodhet në, Rruga, Kolë Heqimi 11, Shkodër

## **FINANCIMI:**

Nga BUXHETI I Spitalit Rajonal, Shkodër

## **PARAQITJA E MATERIALIT:**

### **MATERIALE REFERUESE**

a/ Detyra e projektimit.

b/ Planimetri e gjendjes ekzistuese.

c/ Të dhëna për emërtimin e funksioneve të shërbimit **Obstetrike,Gjinekologji,Neonatologji,ORL-OKL dhe Dermatologji** numri i personelit kryesor dhe atij ndihmës etj.

## **Përshkrimi i detyrës**

### **Objektivi**

Objektivi i projektit është rikonstruksioni i Godina ekzistuese e Maternitetit Shkodër,objekt në administrim të Spitalit Rajonal Shkodër dhe kualifikim i kësaj godinë sipas standardeve aktuale për dhënien shërbimeve shëndetësore.

### **Qëllimi**

Qëllimi kryesor është hartim i projektit, projekt preventivit të rikonstruksionit të godinës dhe projektit të zbatimit, përfshirë ndërhyrjen e plotë arkitektonike dhe inxhinierike.

### **Gjendje ekzistuese dhe ndërhyrjet e propozuara**

Godina ekzistuese e Maternitetit Shkodër,është një godinë aktualisht e amortizur.

**Sipërfaqe rikonstruksionit te godines 4 kateve eshte 3820 m2** , e specifikuar si me poshte:

- Kati përdhe me sipërfaqe totale 1434 m2.
- Kati i I-re teknik me sipërfaqe totale 1155.57 m2
- Kati i II-te Teknik me sipërfaqe totale 779.60 m2
- Kati i III-te Teknik me sipërfaqe totale 450.83 m2

Aktualisht gjendja e godinës paraqitet e amortizuar .

Ndërhyrjet e propozuara, bazuar në nevojat për përmbushje të standardeve funksionale dhe me qëllim administrimin e amortizimin, janë:

1. Rimodelim i godinës.

2. Ndërhyrje strukturore përforcuese për të siguruar qëndrueshmërinë e objektit
3. Ndërhyrje për të vendosur infrastrukturën e nevojshme (furnizim me ujë, furnizim me energji elektrike, shkarkime ujëra të zeza dhe të bardha, sistem ngrohje-ftohje, etj.)
4. Ndërhyrje për të krijuar kushte bashkohore.
5. Ribërje e rifiniturave

### **Shërbimet e kërkuara**

Fituesi duhet të hartojë projektin sipas kësaj detyre projektimi dhe në përputhje me VKM nr 216 date 13.04.2023 Sistemi I integruar I manualit te çmimeve ne ndertim dhe vkm nr 354 date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit per sherbime ne planifikim territori ,projektim,mbikqyrje dhe kolaudim”

Detyra e konsulentit për hartimin e projektit: “Godina ekzistuese e Maternitetit Shkodër ” do të jetë përgatitja e **fazave I ÷ VI.**

### **Faza I. Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit.**

Mbledhja e të dhënave të gjendjes ekzistuese

Analizimi gjendjes ekzistuese dhe identifikimi i problematikave që ndikojnë në hartimin e projektit.

Planifikimi i punës dhe burimeve për realizimin cilësor të projektit

### **Faza II. Projekt idea paraprake**

Projekt ideja paraprake duhet të përfshijë minimalisht:

Studimin e zgjidhjes dhe paraqitjen grafike

Llogaritja paraprake e kostos

Raportin paraprak

### **Faza III. Projekt idea përfundimtare**

Projekt ideja përfundimtare duhet të përfshijë minimalisht:

Vizatimet e zgjidhjes përfundimtare sipas standardeve të projektimit

Raportin teknik, ku përfshihen llogaritjet, studimet, etj

Preventivin;

Të bëjë një prezantim të projektit përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor;

### **Faza IV. Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit**

Përpunimi e dorëzimi i dokumenteve për procedurat e nevojshme juridike e ligjore

### **Faza V+VI. Projekti i zbatimit dhe preventivi përfundimtar**

Projekti i zbatimit duhet të përmbajë:

Vizatimet

Raport teknik

Preventiv (me dhe pa çmime)

Specifikime teknike

Grafik punimesh

Plan shpronësimesh (nëse ka)

## **Vizatimet**

Vizatimet duhet të përmbajnë minimalisht fletët e mëposhtme:

Planimetrinë ekzistuese  
Planimetrinë e objektit të rikonstruktuar  
Prerjet e objektit gjatësore dhe terthore  
Detajet e ndryshme arkitekturore  
Projektin konstruktiv të ndërhyrjes  
Projektin elektrik dhe të rrjetit data dhe internet  
Projektin e gjelbërimit  
Projektin e furnizimit me ujë  
Projektin HVAC  
Projektin e ujërave të zeza dhe të bardha dhe H/Sanitare

Projekti i ujit të ngrohte.  
Detaje rifinitura  
Projekti për daljet e emergjencës  
Sinjalistikë e brendshme  
Imazhe 3d, etj

## **Raport teknik**

Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, jepen llogaritjet e ndryshme të bëra., etj.

## **Preventivi**

Duhet të paraqitet konform formatit tip të preventivit, të miratuar sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi. Çmimet në preventiv do të vendosen, sipas manualit të përditësuar në fuqi. Në rastet kur në preventiv ka zëra punimesh të cilat nuk përfshihen në manual, projektuesi dhe preventivuesi janë të detyruar të bëjnë analiza (An) të veçanta çmimesh, të cilat detyrimisht do të jenë pjesë e dosjes së projektit. Preventivi në fazën përfundimtare të hartimit të tij firmoset detyrimisht nga përfaqësuesi ligjor i firmës(studios) dhe pasi merret në dorëzim nga investitori firmoset dhe nga ky i fundit. Duhet patur parasysh që gjatë hartimit dhe paraqitjes së preventivit, të reflektohet ndarja veçmas e struktura së kostos për punimet ndërtimore dhe teknologjike-ndërtimore dhe veçmas vlera e furnizimit me pajisje të objektit. Se kush përfshihet (cilësohet si pajisje) dhe si bëhet ajo referojuni U.K.M. Nr.2 datë 8/5/2003. Në vlerën limit të kostimit të objektit të aplikohet fondi rezerve 5% dhe vlera e TVSH së (20%). Preventivi i zbatimit të firmoset nga të gjithë aktorët që marrin pjesë në këtë projekt.

## **Specifikime Teknike**

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren.

Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- o Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet që do të përdoren, cilësia e tyre, etj
- o Metoda e kryerjes së punimeve
- o Cilësia e kërkuar e punimeve
- o Formatet e lejuara
- o Ngjyra e rekomanduar

- o Njesia e matjes
- o Etj.

Konsulenti duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.

## **Grafiku i punimeve,**

Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv.

## **A. DETAJIME TË PROJEKTIT TE ARKITEKTURËS:**

Të paraqitet Gen-plani i përgjithshëm dhe Gen-plani i fragmentuar i vendodhjes së objektit.

Të paraqiten planimetritë e kateve .

Prerje të objektit në dy drejtimet gjatësore dhe tërthore.

Te paraqiten fasadat (4 fasadat) si dhe pamjet në 3D të objektit.

Të paraqiten detaje (hollësi) të ndryshme arkitekturore dhe ndërtimore.

Të gjitha fletët e projekteve të arkitekturës të jenë saktësisht të dimensionuar, të kuotuar, saktësisht të dallueshme dhe lexueshme.

Projekti arkitektonik të shoqërohet me albumin e "Specifikimeve të përgjithshme për **punimet e ndërtimit**" **K.T.Z.** si dhe paraqitjen e albumit të "**Shënimeve të veçanta të objektit**".

E gjithë metodologjia e projektimit do të bazohet referuar Kushteve Teknike të Projektimit(K.T.P), dhe Kushteve Teknike të Zbatimit (K.T.Z), standardeve shtetërore në Rep. e Shqipërisë, pa përjashtuar dhe standardet e CE.

Pjese e rëndësishme dhe taksative është dhe bërja e projektit të planit të mobilimit për të gjithë ambientet e punës primare dhe ndihmëse si pjesë integrale e rëndësishme e dosjes së projektit, e cila ndihmon në hartimin e saktë të projekteve për instalimet elektrike dhe H/sanitare, dhe në veçanti në përcaktimin e pozicionit të aksesorëve si, çelësat & prizat, prizat e sistemit të IT (Interneti), TV, telefonisë, kuadrot elektrik, et. Plani mobilimit do të shërbejë dhe për përcaktimin e pozicionit të vendosjes së pajisjeve h/sanitare në dhomat e shërbimit dhe tualete, pajisjet H/S në ambiente specifike si, lavamanë, sistemi i furnizimit me ujë të ngrohtë nga sistem i qendëruar i ujit të ngrohtë, pajisjeve ngrohje-ftohjes Fancoila në mure dhe tavanor, pajisjet e MKZ ( kasete m.k.z. të inkastruara në mur me xham) për rastin tonë në 3 pika, etj. Plani i mobilimit dhe vendndodhja e pajisjeve mjekësore, atyre laboratorike do të shërbejë dhe

nevojës pas verifikimit të objektit në vend.

Ofertuesi detyrimisht duhet të hartojë dhe paraqesë një grafik linear të punimeve ku të jetë përcaktuar kohë zgjatja e punimeve dhe numri mesatar i specialist + punëtor që nevojiten të punojnë për ndërtimin e objektit.

Projektuesi arkitekt dhe ai konstruktor të studiojnë me përparësi mundësinë e kompozimit të një shkalle të re dalje emergjence.

## **B. KËRKESAT FUNKSIONALE:**

### **a. Dhomat e pacientëve:**

Të projektohen dhoma të individualizuara me masa të përshtatshme sigurie duke përfshirë hapësirën për një shtrat, depo dhe një banjo private.

### **b. Zonat e përbashkëta:**

Të planifikohen hapësirat e përbashkëta për terapi grupore, aktivitete dhe relaksim. Sigurohuni që mobiljet dhe pajisjet të përmbushin standardet e sigurisë.

### **c. Dhomat e stafit:**

Të planifikohen stacione pune, dhoma pushimi dhe zyra duke pasur parasysh funksionalitetin dhe privatësinë. Zbatimi i masave të sigurisë për zonat vetëm me personel.

### **Aksesueshmëria:**

#### **a. Pajtueshmëria me aftësinë e kufizuar:**

Të projektohen rampa dhe ashensorë për aksesin e karrigeve me rrota. Sigurohuni që portat dhe korridoret të përmbushin kërkesat e projektimit për PAK.

#### **b. Projektimi universal:**

Të zbatohen parimet universale të projektimit për hapësirat gjithëpërfshirëse. Merrni parasysh nevojat e pacientëve me aftësi të ndryshme.

### **Mbrojtje dhe siguri:**

#### **a. Masat e sigurisë:**

Të parashikohet instalimi i kamerave CCTV në vende strategjike. Të projektohen pika hyrëse me akses të kontrolluar për siguri të shtuar.

#### **b. Daljet e emergjencës:**

Identifikoni dhe planifikoni rrugët e daljes së emergjencës në çdo kat. Sigurohuni që daljet të jenë në përputhje me kodet lokale të ndërtimit.

### **Shërbimet komunale dhe infrastruktura:**

#### **a. Përmirësimi i sistemeve:**

Do projektohen sistemet elektrike për të akomoduar pajisjet mjekësore.

Do projektohet rrjeti hidraulik për kërkesat e objektit të kujdesit shëndetësor.

#### **b. Infrastruktura teknologjike:**

Integrimi i sistemeve të të dhënave elektronike shëndetësore.

Instaloni sisteme komunikimi për koordinimin pa probleme të stafit.



Konsiderata estetike dhe terapeutike:

a. Dizajn i brendshem:

Zgjidhni paleta ngjyrash dhe tekstura qetësuese.

Jepini përparësi dritës natyrore përmes dritareve dhe dritareve të vendosura mirë.

Qëndrueshmeria mjedisore:

a. Zgjidhje me efikasitet të energjisë:

Përdorni ndriçimin LED për efikasitet të energjisë.

Zgjidhni materiale ndërtimi të qëndrueshme me ndikim të ulët mjedisor.

### **C. DETAJIME TE PROJEKTIT KONSTRUKTIV**

Godina eshte një stukturë ekzistuese, e cila duhet të verifikohet për qëndrueshmërinë e saj strukturale. Të gjitha ndërhyrjet do të bëhen në bazë të normave dhe llogaritjeve sipas K.T.Projektimit nga ing. Konstuktur. Në rast se vërehet demtime të konstruksionit mbajtës, të analizohen dhe të planifikohet ndërhyrja për riparimin e tyre. Në rastet e ndryshimeve shtesa ose prishje të mureve ekzistuese apo stukturave prej betonarmeje është detyrë e ing. Konstuktur ti shoqërojë ato me detajet konstruktive përkatëse duke pasë parasysh garantimin në rradhë të parë të qëndrueshmërisë së stukturave ekzistuese por dhe të reja. Ndërtimi i mureve të rinj mund të realizohen me tulla me bira të lehtësuar ose me mure me karton gips. Zgjedhja bëhet nga arkitekti në bashkëpunim me konstrukturin.

Fletët e mundshme të konstruksionit të shoqërohen me tabelat respektive të paraqitjes së pozicioneve dhe peshës së hekurave për çdo stukturë b/arme.

### **D. DETAJIME TE PROJEKTIT TE INSTALIMEVE**

Punimet H/sanitare për; furnizimin me ujë 7/24, sistemi i ngrohje-ftohjes, ventilim aspirim, sinjalizim dhe mbrojtje nga zjarri, linjat e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha, rezervuarët e ujit, instalimet dhe kuadrot elektrike të T.U dhe te tjera, të projektohen referuar përshkrimeve te përgjithshme si vijon:

#### **Projekti për punimet H/Sanitare.**

Në ambientet e objektit do të projektohen: blloku i nyjeve sanitare për personelin e përhershëm të administratës veçmas për burra dhe veçmas për gra. Çdo bllok nyje sanitare të pajiset me klozetë allafranga, lavaman me këmbë me grup mishelator. Në çdo nyje sanitare të projektohet dhe preventivohen të gjithë aksesorët ndihmës që nevojiten për një funksion normal. Në çdo kat të projektohen ambiente nyje sanitare për pacientët (burra+gra) , ku njëra nga këto të përmbushë kushtet për PAK.

Çdo dhomë mjeku të jetë e pajisur me lavaman me uje të ngrohtë dhe shkarkim.

Nyjet sanitare të jenë të projektuara me ventilim, natyral ose artificial.

Dyshemeja e nyjeve sanitare të hidroizolohet. Çdo pajisje të kompletohet me rubinete filtër në hyrje për ujin e ngrohtë dhe atij të ftohtë. Duke qene objekt me prezencë të konsiderueshme njerëzish dhe personelit, është e këshillueshme që në magjistralet kryesore të furnizimit me ujë dhe sidomos të shkarkimeve të projektohen pika apo detaje për kontroll dhe zhbllokim në raste defektesh. Detyrë e

projektuesit është të përcaktojë saktë dhe me funksion të garantuar, pikën e shkarkimit të ujërave në kolektorin kryesor që administron Bashkia.

Garantimi i furnizimit me ujë 7/24 pa ndërprerje të vlerësohet me furnizimin dhe montimin e rezervuarëve me kapacitet sipas nevojës në litra të pajisur me galexhant dhe elektropompë thithëse dhe shtytëse me rregjim pune automatik.

### **Mbrojtja ndaj Zjarrit.**

Te projektohet dhe një rezervuar i veçantë uji. që do të shërbejë enkas për furnizimin me ujë të sistemit të mbrojtjes nga zjarri. Pjesë e sistemit të mbrojtjes nga zjarri është projektimi në tavan i detektorëve të zjarrit, të lidhur me sistemin sinjalizues dhe të alarmit, si brenda në objekt, por dhe në fasadën e tij, për dhënien e sinjalit në rast rënie zjarri. Të projektohet dhe preventivohet dhe vendosja e fikseve të lëvizshëm (me bombola) në ambiente të përbashkëta dhe të dukshme në korridore.

### **Për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes së objektit.**

Ky sistem të projektohet në tërësinë e tij, me sistem qendror të montuar në ambientin e jashtëm si për ngrohjen ashtu dhe për ftohjen. Pozicioni vendosjes së sistemit dhe fuqia e tij të përcaktohet nga ing.Instalator. Propozojmë që linjat e furnizimit të sistemit të projektohen mbi tavanet e varura në koridore dhe të termoizoluara.

### **Furnizimi me ujë të pijshëm.**

Furnizimi me ujë të pijshëm do të bëhet nga rrjeti ekzistues dhe për raste të mungesës së tij (avari) do furnizohet nga rezervuari posaçëm me veprim me galexhant elektrik automatik me pompë shtytëse. Të vendoset në projekt dhe preventiv matës i ri uji.

### **Per sistemin e furnizimit me uje te ngrohte**

Te projektohet nje sistem qendror i ujit te ngrohte me ngrohje nga rrezatimi djellor i vendosur ne tarrace dhe sistem ngrohje konvencionale me energji elektrike, i cili shpërndahe në të gjithë objektin dhe pikat e nyjeve sanitare

### **Projekti për punimet Elektrike.**

Furnizimi i objektit do të bëhet nga kabina (paneli) kryesor, i cili do të projektohet. Të projektohen kuadro elektrik komandimi (KE) dhe kontrolli të veçanta si për; instalimin e ndriçimit, sistemin e fuqisë, sistemin e kondicionimit dhe në veçanti sistemin e furnizimit të aparateve të vecanta më vete. Të vlerësohet projektimi i burimit rezervë me moto gjenerator me karakteristika bashkëkohore i pajisur me silenciator, me futje në punë automatikisht të gjithë sistemit elektrik të objektit apo system UPS për sisteme të veçanta shërbimi shëndetësor.

Punimet elektrike në objektin në fjalë do të projektohen të reja, sipas normave dhe standarteve bashkëkohore të vendit tonë (K.T.P.), pa përjashtuar dhe përshtatjen me normat e CE.

Në objektin në fjalë të realizohet ndriçimi me ndriçues ekonomik. Në ambiente të vecanta mund të planifikohet dhe ndriçim dekorativ. Në ambientet e përbashkëta si: korridore, në hyrje, në recepsion por dhe në ambiente pune shumë të rëndësishme të vendosen ndriçues emergjence me vetë karikim.



Objekti të pajiset me kamera vëzhguese, për vëzhgimin si të ambienteve të përbashkëta brenda objektit, ashtu dhe për vëzhgimin e ambienteve jashtë tij.

Të projektohet sistem telefonie komunikimi i brendshëm, me central telefonik qendror.

Te projektohet dhe realizohet tokëzim i ri i aparaturave kryesore që kanë nevojë , konform normave dhe specifikimeve për një tokëzim perfekt. Të projektohet ndriçim i lehtë i territorit me ndriçuese në shtylla metalike ose në variant tjetër. Të projektohen për këtë objekt minimum 2-3 numra të telefonisë fikse. Në një vend të dukshëm në fasadë të projektohet burim furnizimi me energji për ndriçimin e logos së institucionit.

Te projektohen për ambiente të veçanta, instalimi i linjave dhe prizave për TV me marrje sinjali qendror.

Githashtu në të gjitha ambientet e punës të projektohen linjat dhe prizat e internetit që do të lidhen me serverin kryesor.

Bazë për përcaktimin e pozicionit të prizave të çdo lloji do të jetë plani i mobilimit.

Lidhur me sistemin e IT, përfshi serverin dhe rrjetin kompjuterik, do të duhet në mënyrë taksative konsultimi i ofertuesit me investitorin, për të marrë kërkesat e përgjithshme dhe specifike që kërkon investitori për këtë sistem, si dhe zbatimi i udhëzimeve nga AKSh-i.

Sipërfaqet kryesore që kërkojnë shërbimet sipas planimetrisë bashkëlidhur.

**Ofertuesi fitues ka detyrimin që gjatë periudhës së hartimit të projekt preventivit të zbatimit të konsultohet paraprakisht me stafin e specializuar të investitorit, në mënyrë që çdo sygjerim, ndryshim, propozim apo paqartësi mes palëve, këto të zgjidhen gjatë intervalit kohor të bërjes së projektit, në të kundërt investitori gëzon të drejtën e refuzimit të marrjes në dorëzim, dhe mos financimin e projektit.**